



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot

Vlorë, më _____ 2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Për: **BOE**

“ASI-2A CO” shpk me Nipt K53002402C dhe “VISCONS GROUP” shpk me Nipt L96513208E

Seli/Zyra Qendrore:

Fier, Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6

Adresa:

Tirane Kavaje, Lagjja nr.1, Rruga Indrit Cara, Pallat 3-katesh, Nr.6410, Kati 1.

Vlorë, Lagjja 28 Nëntori, Pallati Invest, kati 1

Procedura e prokurimit/lotit: **PROCEDURE E HAPUR, PUNË**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-86260-11-03-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i Shkollës Avni Rustemi”**

6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimin e Operatorëve (BOE)

“ASI-2A CO” shpk me Nipt K53002402C dhe “VISCONS GROUP” shpk me Nipt L96513208E

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **39,973,315.00 (tridhjetë e nëntë million e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëmbëdhjetë)lekë pa TVSH;**

2. AVDULI shpk me Nipt J66703306O

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **42,914,014.00 (dyzetë e dy million e nëntëqind e atëmbëdhjetë mijë e katëmbëdhjetë)lekë pa TVSH;**

3. Bashkimin e Operatorëve (BOE)

C O L O M B O shpk me Nipt J82916489E dhe BAJRAMI N. shpk me Nipt K02727202O

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **44,597,868.00 (dyzetë e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;**

4. ZEQILLARI shpk me Nipt L61912024O

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme**49,204,064.5 (dyzetë e nëntë milion e dyqind e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër.pesë) lekë pa TVSH;**

5. Bashkimin e operatorëve

LIS KONSTRUKSION shpk me Nipt K66613407H dhe VIANTE Konstruksion shpk me Nipt K47103804L

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme**49,600,422.00 (dyzetë e nëntë milion e gjashtëqind mijë e katërqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH,**

6. Bashkimi i operatorëve (BOE)

ABG Ndertim shpk me Nipt K03816401O dhe EVEREST shpk me Nipt J78311921L

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme**51,366,954.63 (pesëdhjetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër.63) lekë pa TVSH.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. ZEQILLARI shpk me Nipt L619120240

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **49,204,064.5** (dyzetë e nëntë milion e dyqind e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër.pesë) lekë pa TVSH;

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim **2.3.4** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë

Drejtuesi teknik te paragese nje deklarate personale me shkrim qe nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e cila duhet te bashkshoqëroje deklaratën e administratorit.

*(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit. **Ne te gjitha rastet drejtuesi teknik duhet të paragesë deklaratën personale me shkrim qe nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e cila duhet te bashkshoqëroje deklaratën e administratorit**).*

Nga verifikimi i dokumentacionit te shoqërisë “Zeqillari” shpk konstatohet operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë te administratorit të shoqërisë që deklaronte drejtuesin teknik të punimeve në objekt Znj Besire kastrati porne dokumentacionin paraqitur ne spe nuk është paraqitur deklaratë personale me shkrim e drejtuesit teknik Besire Kastrati qe kjo e fundit nuk është e angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë e pranishme gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e cila duhet te bashkshoqëroje deklaratën e administratorit Komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriterin përcaktuar në pikën 2.3.4 të kriterëve te vecanta për kualifikim kapaciteti teknik sikundër kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Thënë kjo operatori ekonomik “Zeqillari” shpk nuk plotëson kriterin përcaktuar nga autoritetin kontraktor në pikën 2.3.4 të kriterëve të vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

- 1. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.16 percaktohet se: Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Autovinç me kosh 1 copë.**

Gjithashtu në plotësim të dokumentacionit provues për këto mjete autoriteti kontraktor ka kërkuar:

- a) Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- b) Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik Zeqillari shpk ka deklaruar ne Formularin përmbledhes të vetdeklarimit dhe në shtojcën e paraqitur për makineritë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor sa më poshtë:

1. Autovinç me kosh marrë me qera me kontratë Nr 1268 Rep Nr 729 Kol Date 03.10.2022 vetdeklaruar në shtojcën e makinerive.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “i” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”; Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[....]”

Referuar kërkesës së përcaktuar në dokumentat e tenderit është qartësisht e kuptueshme se autoriteti kontraktor ka kërkuar mjete vetlëvizëse/ që qarkullojnë në rrugë duke përcaktuar fjalën “auto” për këto mjete dhe jo mjete që kryejnë punime vetëm brenda kantierit të cilat nuk plotësojnë kërkesën për lëvizshmëri duke mos kryer funksionin për të cilin janë kërkuar nga autoritetit kontraktor .

Referuar Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr.8378, datë 22.7.1998, i ndryshuar në nenin 113 të tij pika 2 citohet se:

- “Për të qarkulluar në rrugë **makinat teknologjike duhen regjistruar** në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, **që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërtëton se është pronari i mjetit**”.

dhe në vijim në pikën 4 të tij parashikohet se:

- “Për të qarkulluar në rrugë **makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit**”.

Në mbështetje të bazes ligjore sa më sipër ligjvenesi ka përcaktuar se:

Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”;

Sa më sipër Komisioni i vlersimit të ofertave pas shqyrtimit të vetdeklarimit të bërë nga operatori ekonomik në lidhje me makineritë të cilat do ti vihen në dispozicion autoritetit kontraktor për realizimin e kontratës konstaton se operatori ekonomik për mjetin Autovinç me kosh nuk ka deklaruar mjetin sipas kerkesës së autoritetit kontraktor pasi nuk ka deklaruar targen e mjetit por si dokumentacion provues qe mund ti vihet ne dispozicion autoritetit kontraktor në rast kualifikimi ka deklaruar kontrate marrje me qera mjete duke mos deklaruar targën e mjetit dhe për rrjedhoje duke mos plotësuar kushtin e vendosur nga autoriteti kontraktor për paraqitje mjetei autovinç me kosh (mjet qe qarkullon ne rruge) dhe qe duhet te jete i pajisur me targa njohjeje te cilat ne kete faze duhet te deklaroheshin nga operatori ekonomik referuar akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi si dhe kerkeses se autoritetit kontraktor dhe perpara shpalljes se njoftimit te fituesit duhej te paraqitej dokumentacioni provues për mjetet që shënohen në regjistra publikë. Në përfundim të analizës së fakteve komisioni i vlersimit të ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit mbi dokumentacionin provues qe operatori ekonomik do të paraqese per kete mjet nuk plotëson kërkesat e kriterëve të kualifikimit për disponimin e mjetit sikundër përcaktuar në dokumentet e tenderit të vendosura nga autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i pavlefshëm.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

2. Bashkimi i operatorëve (BOE)

LIS KONSTRUKSION shpk me Nipt K66613407H dhe VIANTE Konstruksion shpk me Nipt K47103804L

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **49,600,422.00 (dyzetë e nëntë milion e gjashtëqind mijë e katërqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH,**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim **2.3.15 Operatori/et ekonomike ofertues për materialet :**

- Hidroizolues me bazë cimento
- Astar për Hidroizolues
- Llac për mbushje dhe suvatim
- Bojë hidroplastike
- Profile per dritare dhe dyer plastike**
- dyer druri**
- Sistem kapote (Termoizolimi me polisterol)
- Parket druri lafonier dhe prozhektor**
- Ndricesa plafonier dhe prozhektor

Per materialet listuar sa me siper operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Për rastet kur operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, ose distributori të autorizuar. ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit **ose** midis **ofertuesit -distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat cituar më siper.

Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik konstatohet se per materialet “Profile per dritare dhe dyer plastike” operatori ekonomik “Euroalb” shpk disponon autorizim prodhuesi të datës 03.05.2019 nga shoqëria “Ëeiss Profil Albania” dhe gjithashtu jane paraqitur katalogjet për dyer dhe dritare plastike.Referuar katalogëve të dorëzuar konstatohet se katalogjet janë të papërkthyer në gjuhën shqipe në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe me dokumentat e tenderit të publikuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 2 të nenit 24 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.”

”. III.1.6. Në dokumentat e tenderit, “ Njoftimi i kontrates Procedura, pika 4.7 është përcaktuar shprehimisht:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

X

Anglisht

Gjithshtu, në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit, “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, përcaktohet shprehimisht se: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip”.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të ofertave konstaton se katalogët e paraqitur nga operatori ekonomik nuk janë paraqitur në gjuhën shqipe, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësisht të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, për më tepër që nuk janë të përkthyer të paktën vetëm ato pjesë të katalogut që kanë të bëjnë me përshkrimin apo specifikimet teknike të mallit apo produktit të kërkuar.

Përcaktimi i bërë në dokumentat e tenderit, si në seksionin “Njoftimin e Kontratës”, ashtu edhe në Shtojcën 7 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit, aq më tepër në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përkufizuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Sqarojmë se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

Në kushtet kur, në dokumentat e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme, të cilat janë detyrimisht për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe detyrimisht për të mos u ndryshuar nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar qartë e saktë që “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”, si edhe gjuha e përdorur është përcaktuar “Gjuha Shqipe”, atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer i noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky gjithpërfshirës që i përket çdo lloj dokumentacioni që do të paraqitet në këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Ndërkohë që edhe ligjvënësi e ka përcaktuar dhe e ka sqaruar mjaft qartë momentin dhe mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit në një procedurë prokurimi, përse i përket gjuhës së përdorur. Referuar seksionit I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjykon se operatori ekonomik nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto

dokumenta, pasi operatori ekonomik është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elementë që janë gjykuar të nevojshëm dhe të domosdoshëm nga ana e këtij të fundit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Bazuar në sa më sipër sqarojme se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me ligjin dhe aktet ligjore në fuqi për prokurimin publik. Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Lis Konstruksion” sh.p.k.& “Viante Konstruksion” shpk në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

2. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në plotësim të pikës 2.3.5 për materialin “Parket druri” nga komisioni i vlerësimit të ofertave konstatohet se është paraqitur autorizim prodhuesi i shoqërisë “Tarket” për shoqërinë Delta shpk por nuk është paraqitur autorizimi i shoqërisë Delta shpk për BOE “Lis Konstruksion” sh.p.k.& “Viante Konstruksion” shpk dhe gjithashtu katalogu është i papërkthyer në gjuhën shqipe.

Për materialet “Dyer druri” është paraqitur autorizim nga shoqëria ERALD shpk shoqëruar me katalog në të cilin janë paraqitur vetëm foto pa asnjë të dhënë teknike të materialit.

Referuar përcaktimit në dokumentat e tenderit është kërkuar nga autoriteti kontraktor specifikisht:

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat cituar më sipër.

Nga sa më sipër përcaktuar dhe nga verifikimi në sistem i katalogut komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon që katalogu nuk është paraqitur i plotë me të dhënat teknike sikundër përcaktuar nga autoriteti kontraktor duke mos plotësuar kriterin sa më sipër përcaktuar.

2. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.16 percaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Autovinç me kosh 1 copë.*

Gjithashtu në plotesim të dokumentacionit provues për këto mjete autoriteti kontraktor ka kërkuar:

- c) Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- d) Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.

Në plotësim të këtij kriteri bashkimi i operatorëve ekonomik “Lis Konstruksion” sh.p.k. & “Viante Konstruksion” shpk ka deklaruar ne Formularin permblledhes të vetdeklarimit dhe në shtojcen e paraqitur per makineritë sipas kërkesës se autoritetit kontraktor sa më poshtë:

3. Autovinç me kosh marrë me qera me kontratë Nr 4785 Rep Nr 809 Kol Date 19.07.2023vetdeklaruar në shtojcën e makinerive me nr.shasie ELET 1550427.
4. Autovonç me kosh/ pirun teleskopik ne pronesi vetdeklaruar ne shtojcen e makinerive me fature tatimore.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “i” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”; Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[....]”

Referuar kërkesës së përcaktuar në dokumentat e tenderit është qartësisht e kuptueshme se autoriteti kontraktor ka kërkuar mjete vetëlëvizëse/ që qarkullojnë në rrugë duke përcaktuar fjalën “auto” për këto mjete dhe jo mjete që kryejnë punime vetëm brenda kantierit të cilat nuk plotësojnë kërkesën për lëvizshmëri duke mos kryer funksionin për të cilin janë kërkuar nga autoritetit kontraktor .

Referuar Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr.8378, datë 22.7.1998, i ndryshuar në nenin 113 të tij pika 2 citohet se:

- “Për të qarkulluar në rrugë **makinat teknologjike duhen regjistruar** në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; **që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërtëton se është pronari i mjetit**”.

dhe në vijim në pikën 4 të tij parashikohet se:

- “Për të qarkulluar në rrugë **makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit**”.

Në mbështetje të bazes ligjore sa më sipër ligjvenesi ka përcaktuar se:

Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti”;

Sa më sipër Komisioni i vlersimit të ofertave pas shqyrtimit të vetdeklarimit të bërë nga operatori ekonomik në lidhje me makineritë të cilat do ti vihen në dispozicion autoritetit kontraktor për realizimin e kontratës konstaton se operatori ekonomik për mjetin Autovinç me kosh nuk ka deklaruar mjetin sipas kërkesës së autoritetit kontraktor pasi nuk ka deklaruar targën e mjetit por si dokumentacion provues qe mund ti vihet në dispozicion autoritetit kontraktor në rast kualifikimi ka deklaruar kontrate marrje me qera mjeti duke mos deklaruar targën e mjetit dhe për rrjedhojë duke mos plotësuar kushtin e vendosur nga autoriteti kontraktor për paraqitje mjeti autovinç me kosh (mjet qe qarkullon në rrugë) dhe qe duhet te jete i pajisur me targa njohjeje te cilat në kete faze duhet te deklaroheshin nga operatori ekonomik referuar akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi si dhe kërkeses se autoritetit kontraktor dhe përpara shpalljes se njoftimit të fituesit duhej të paraqitej dokumentacioni provues për mjetet që shënohen në regjistra publikë. Në përfundim të analizës së fakteve komisioni i vlersimit të ofertave arrin në konkluzionin se nga të dhënat e plotësuara në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit mbi dokumentacionin provues qe operatori ekonomik do të paraqese për kete mjet nuk plotëson kërkesat e kriterëve të kualifikimit për disponimin e mjetit sikundër përcaktuar në dokumentet e tenderit të vendosura nga autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i pavlefshëm.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

3. Bashkimi i operatorëve (BOE)

ABG Ndertim shpk me Nipt K03816401O dhe EVEREST shpk me Nipt J78311921L

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **51,366,954.63 (pesëdhjetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër.63) lekë pa TVSH.**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se BOE nuk plotëson në kriteret e përgjithshme për kualifikim Shtojcën 3, përkatësisht sigurimi i ofertës nuk është plotësuar sipas afateve ligjore, 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve (BOE) “ASI-2A CO” shpk me Nipt K53002402C dhe “VISCONS GROUP” shpk me Nipt L96513208E** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **39,973,315.00 (tridhjetë e nëntë million e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëmbëdhjetë)lekë pa TVSH/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **BASHKIA VLORE** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JOX